



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit
P-084

Prishtinë, më 8 mars 2017, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C -301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 8 MARS 2017

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Aida Dërguti dhe Fikrim Damka, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Zenun Pajaziti, Ismet Beqiri, Albulena Haxhiu, Pal Lekaj, Haxhi Shala dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Avni Bytyçi, Blerim Latifi dhe Valmir Klaiqi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga OSBE-ja: Saniye Berisha,

Nga EUSR-ja: Blerta Bejtullahu dhe

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati.

Mbledhjen e drejtoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, i ndihmuar nga nënkryetari Xhavit Haliti.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme
2. Procedimi i Projektligjit nr. 05/L-156 për Forcën e Sigurisë së Kosovës
3. Vazhdimi i seancës me pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 2 mars 2017
4. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave

* * *

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, e mbajtur më 23 shkurt 2017

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, e mbajtur më 23 shkurt 2017.

2. Procedimi i Projektligjit nr. 05/L-156 për Forcën e Sigurisë së Kosovës

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë së Kuvendit se Presidenti i Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi, në bazë të Kushtetutës dhe Rregullores së Kuvendit të Kosovës, i ka propozuar Kuvendit për shqyrtim dhe miratim Projektligjin nr. 05/L-156 për Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me procedimin e projektligjit të lartshënuar, nxori këtë:

Përfundim

Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të paraqesë mendim lidhur me Projektligjin nr. 05/L-156 për Forcën e Sigurisë së Kosovës, të propozuar nga Presidenti i Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi, si dhe të përgatitë Deklaratën e ndikimit buxhetor dhe Deklaratën për përafrim me legjislacionin e BE-së të këtij projektligji.

3. Vazhdimi i seancës me pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 2 mars 2017

Kryetari i njoftoi deputetët se Grupi i Grave Deputete ka kërkuar që vazhdimi i seancës plenare të Kuvendit, e caktuar për datën 8.03.2017, për shkak të 8 Marsit, të shtyhet për datën 9 mars 2017.

Me propozimin e Kryetarit, Kryesia vendosi që seanca plenare t'i vazhdojë punimet më 9 mars 2017, me fillim në orën 10:00, me pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 2 mars 2017.

4. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave

1. Propozim-programi i Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2017

Kryesia vendosi që Propozim-programi i Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2017 të radhitet në rend të ditës për seancën plenare të radhës.

2. Kërkesa e deputetes Teuta Haxhiu, e mbështetur edhe nga 9 deputetë të tjerë nënshkrues, për debat parlamentar me temën: Moszbatimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga Qeveria e Republikës së Kosovës

Kryesia vendosi që kërkesa e deputetes, znj. Haxhiu, të radhitet në rend të ditës për seancën plenare të radhës.

3. Kërkesa e deputetëve Bekim Haxhiu dhe Xhevahire Izmaku, e mbështetur edhe nga 8 deputetë të tjerë nënshkrues për debat parlamentar në lidhje me shkeljen e të drejtave të punëtorëve në Kosovë

Kryesia vendosi që kërkesa e deputetëve, z. Bekim Haxhiu dhe Xhevahire Izmaku, të radhitet në rend të ditës për seancën plenare të radhës.

4. Kërkesa e Komisionit për Buxhet dhe Financa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Kroaci, prej 12-15 mars 2017

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

Vendim

1. Anëtarëve të Komisionit për Buxhet dhe Financa të Kuvendit të Kosovës: Naser Osmani, Safete Hadërgjonaj, Salih Morina, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri dhe Enver Hoti u lejohet udhëtimi zyrtar në Kroaci prej 12-15 mars 2017.

2. Të gjitha shpenzimet për realizimin e këtij udhëtimi për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës, sipas kërkesës së bashkangjitur me nr. 05/3194/DO-1632, datë 23. 2. 2017.

5. Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve lidhur me pritjen e delegacionit nga SHBA-ja, më 19 shkurt 2017

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

Vendim

Miratohet raporti nr. 05/3231/DO-1657, datë 2. 3. 2017, i shpenzimeve lidhur me pritjen e delegacionit nga SHBA-ja, i cili ka qëndruar në Kosovë më 19 shkurt 2017.

6. Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve për delegacionin nga Britania e Madhe, i cili ka qëndruar në Kosovë më 12-16 shkurt 2017

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

Vendim

Miratohet raporti nr. 05/3231/DO-1656, datë 2. 3. 2017, i shpenzimeve lidhur me pritjen e delegacionit nga Britania e Madhe, i cili ka qëndruar në Kosovë më 12-16 shkurt 2017, sipas vendimit nr. 05-V- 507, datë 23 shkurt 2017.

7. Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve për delegacionin nga Japonia, i cili ka qëndruar në Kosovë nga data 15-18 shkurt 2017

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

Vendim

Miratohet raporti nr. 05/3231/DO-1655, datë 2. 3. 2017, i shpenzimeve lidhur me pritjen e delegacionit nga Japonia, i cili ka qëndruar në Kosovë nga data 15-18 shkurt 2017, sipas vendimit nr. 05-V-512, datë 23 shkurt 2017.

8. Kërkesa e deputetëve Puhie Demaku dhe Salih Morina për lejimin e udhëtimit zyrtar në Pragë (Çeki), prej 21-24 mars 2017

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

Vendim

1. Deputetëve të Kuvendit të Kosovës: Puhie Demaku, Salih Morina dhe Sërgjan Popoviq, u lejohet udhëtimi në Pragë (Çeki), prej 21-24 mars 2017.

2. Shpenzimet e udhëtimit dhe të akomodimit për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga organizatori, ndërsa mëditjet mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës.

9. Kërkesa e deputetëve Muhamet Mustafa dhe Daut Haradinaj për lejimin e udhëtimit zyrtar në Kroaci prej 17-19 mars 2017

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

Vendim

1. Deputetëve të Kuvendit të Kosovës, Muhamet Mustafa dhe Daut Haradinaj, u lejohet udhëtimi në Kroaci prej 17-19 mars 2017.

2. Shpenzimet për realizimin e këtij udhëtimi për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen në përputhshmëri me kërkesën e bashkangjitur me nr. 05/3239/DO-1661, datë 2. 3. 2017.

10. Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve të fushatës tradicionale të kartolinave të fundvitit 2016 nga SOS fshatrat e fëmijëve

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

Vendim

Miratohet kërkesa për mbulimin e shpenzimeve të fushatës tradicionale të kartolinave të fundvitit 2016 nga SOS fshatrat e fëmijëve, në shumën prej 1 000 €.

11. Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve të Samitit të kryetarëve të komisioneve të punëve të jashtme të vendeve të BE-së dhe Ballkanit, të mbajtur në Prishtinë nga data 19-22 shkurt 2017

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

Vendim

Miratohet raporti nr. 05/3234/DO-1660, datë 2. 3. 2017, i shpenzimeve të Samitit të kryetarëve të komisioneve për punë të jashtme të vendeve të BE-së dhe Ballkanit, të mbajtur në Kosovë nga data 19-22 shkurt 2017, sipas vendimit nr. 05-V-476, datë 16 janar 2017.

12. Kërkesa e Komisionit për Punë të Jashtme për kompensimin e mëditjeve edhe për një (1) ditë shtesë lidhur me vizitën e realizuar në Shqipëri prej 09-11 shkurt 2017

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

Vendim

Të gjithë pjesëmarrësve nga Komisioni Parlamentar për Punë të Jashtme, të cilët kanë realizuar vizitën në Shqipëri prej datës 9-11 shkurt 2017, t'u kompensohen mëditjet edhe për një (1) ditë shtesë, sipas kërkesës së bashkangjitur me nr. 05/3201/DO-1639, datë 27 shkurt 2017.

13. Kërkesa e sindikatave të punëtorëve të NPQ Posta e Kosovës sh. a. lidhur me vendimin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës

Kryesia, pasi e diskutoi kërkesën e lartshënuar, nxori këtë:

Përfundim

Ngarkohet Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri që ta shqyrtojë kërkesën e sindikatave të punëtorëve të NPQ Posta e Kosovës Sh. A, si dhe peticionin e punëtorëve të kësaj organizate lidhur me vendimin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës dhe Kryesisë së Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime lidhur me këtë çështje.

14. Kërkesa e deputetëve Xhevahire Izma, Salih Morina, Safete Hadërgjonaj dhe Arben Gashi për lejimin e udhëtimit zyrtar në SHBA

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

Vendim

1. Deputetëve të Kuvendit të Kosovës, Xhevahire Izma, Salih Morina, Safete Hadërgjonaj dhe Arben Gashi, u lejohet udhëtimi në Washington D.C., SHBA, prej datës 16-19 prill 2017.

2. Të gjitha shpenzimet për realizimin e këtij udhëtimit për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës, sipas kërkesës së bashkangjitur me nr.05/3241/DO-1663, datë 6. 3. 2017.

15. Kërkesa e deputetes Sala Berisha-Shala për lejimin e udhëtimit zyrtar në SHBA prej 1-6 maj 2017

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

Vendim

1. Deputetes së Kuvendit të Kosovës, Sala Berisha-Shala, i lejohet udhëtimi në SHBA prej datës 01-06 maj 2017.

2. Të gjitha shpenzimet për realizimin e këtij udhëtimi për të lartshënuarën në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës, sipas kërkesës së bashkangjitur me nr. 05/3240/DO-1662, datë 6. 3. 2017.

16. Kërkesa e ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, z. Arsim Bajrami, për procedimin e Projektligjit për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës

Kryesia, pasi e diskutoi kërkesën e ministrit, z. Bajrami, vendosi që Projektligji për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës të radhitet në rend të ditës për seancën plenare të radhës.

17. Njoftimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me realizimin e udhëtimit zyrtar në Austri, prej 7-10 shkurt 2017

Kryesia u njoftua me shkrim me raportin e Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me realizimin e udhëtimit zyrtar në Austri prej 7-10 shkurt 2017.

18. Njoftimi i Nënkomisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Shqipëri prej 10-12 shkurt 2017

Kryesia u njoftua me shkrim me raportin e Nënkomisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Shqipëri prej 10-12 shkurt 2017.

5. Pikat shitesë:

1. Kërkesa e deputetes Sala Berisha-Shala për mbylljen e avancit

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

Vendim

Miratohet kërkesa e deputetes Sala Berisha-Shala për mbylljen e avancit lidhur me mbajtjen e punëtorisë të Grupit të punës për Nismën Legjislative “Ligji për miniera dhe minerale”, në Durrës (Shqipëri), prej datës 2-5 mars 2017, sipas kërkesës së bashkangjitur, të datës 7. 3. 2017.

2. Kërkesa e Komisionit Parlamentar për Punë të Jashtme për lejimin e udhëtimit në Bosnjë-Hercegovinë

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

Vendim

1. Anëtarëve të Komisionit për Punë të Jashtme të Kuvendit të Kosovës: Elmi Reçica, Teuta Rugova, Qerim Bajrami, Blerta Deliu-Kodra, Luljeta Veselaj-Gutaj dhe Pal Lekaj u lejohet udhëtimi në Sarajevë, Bosnjë-Hercegovinë, prej 20-23 mars 2017.

2. Të gjitha shpenzimet për realizimin e këtij udhëtimi për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit, sipas kërkesës së bashkangjitur me nr. 05/3250/DO-1671, datë 8. 3. 2017.

Nënkryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 11:15 minuta.

Nënkryetari i Kuvendit:

Xhavit HALITI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale